

UDHËZIM

Për plotesimin e Formularit te Aplikimit per

FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

KSF/RSS/01

Dorëzoni aplikacionet tuaja të plotësuara në Zyrën Rajonale të Rekrutimit ose tek Ekipi Mobil për Rekrutim.

Pjesa 1

PROCEDURAT E APLIKIMIT

Personeli i interesuar për anëtarësim në FSK duhet të dorëzojë formularin e aplikacionit, dëshminë e shtetësisë, dëshminë e moshës dhe diplomat e shkollimit ose çertifikatat e kryerjes së kurseve. Shënimet 3, 5, 7 dhe 10 në këtë fletushkë japin informata për dokumentacionin që kërkohet. Aplikacionet, në të cilat mungojnë të dhënat ose mungojnë dokumentet, nuk do të merren parasysh.

Individët të cilët i plotësojnë aplikacionet e tyre me sukses, do të merren parasysh për procesin e shqyrtimit formal. Aplikantët e zgjedhur do të marrin një njoftim me shkrim për datën dhe lokacionin e shqyrtimit. Individët të cilët nuk përzgjedhen do të njoftohen me shkrim dhe nuk do të jepen arsyet për mos-përzgjedhje.

Aplikantët **KËSHILLOHEN QË ASESI** të mos japin njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies së tyre aktuale të punës deri sa ata të kenë **KRYER ME SUKSES PROCESIN E SHQYRTIMIT DHE TË JENË INFORMUAR ME SHKRIM**, për përzgjedhjen e tyre për anëtarësim në FSK. Në këtë kohë do të jepet njoftimi për datat e trajnimeve për rekrutët.

Nga ju kërkohet që ta nënshkruani dhe ta shënoni datën në formularin e aplikacionit për të konfirmuar se informatat të cilat i keni dhënë janë të vërteta dhe të sakta. Informatat të cilat i jepni do të mbahen dhe mbrohen.

FSK-ja e respekton kontributin e veçantë të secilit individ, pa marrë parasysh origjinën etnike, gjuhën, gjininë, orientimin seksual, pozitën shoqërore ose ndonjë rrethanë tjetër personale.

DEKLARATË RRETH POLICËS PËR VERIFIKIM

Në mënyrë që të mbrohet integriteti Institucional dhe në mbështetje të Autoriteteve në Kosovë, është policë e NATO-s, natyra e së cilës është interes vital për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, që të mos pranohen në punë ata që janë të involvuar ose implikuar me aktivitetet nevijim:

- Spiunazhë;
- Terrorizëm;
- Sabotazhë;
- Vepra që kanë për qëllim të përmbysin apo të mos konsiderojnë demokracinë Kosovare, nëpërmes mënyrave politike, industriale apo të rrezikshme, apo:
 - është apo ka qenë kohëve të fundit:
 - Anëtar i ndonjë organizate e cila promovon ndonjë prej aktiviteteve të lartpërmendurta; ose
 - I implikuar me ndonjë organizatë apo anëtar të saj në ndonjë menyrë që do të ngritë dyshim të arsyeshëm rreth mvarësisë së tij/saj; ose
 - Ka treguar josiqeritet apo mungesë integriteti që bën të dyshoj rreth m'varësisë tek ai/ajo; ose
 - Ka demonstruar sjellje të cilat tregojnë mos-m'varësi te ai/ajo; ose
 - Eshtë i luhatshëm ndaj presionit apo ndikimit jo të mirë.

DEKLARATË RRETH POLICËS PËR VERIFIKIM vazhdim

Në përpuethshmëri me policën e lartëpërmendur, Ekipi Për Verifikim (FVU) i NATO KFOR-it do të bëjë verifikimin e të gjithë individëve të cilët aplikojnë për FSK apo organizatat mbështetëse siq janë mFSK (Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës)

Certifikata e Sigurisë zakonisht përmbanë:

- Një kontrollim nga të gjitha burimet e mundshme në dispozicion të rekordeve kriminale, sidomos rekordeve Policore dhe Juridike;
- Një kontrollim nga burime relevante të rekordeve të KFOR-it dhe rekordeve tjera nderkombëtare;
- Referencës nga njerëzit të cilët njohin karakterin e personit. Këto kontrollime mund të përmbajnë intervista.

Ne disa raste, kontrollime të mëtutjeshme mund të pasojnë mvarësisht nga grada, përgjegjësitë dhe qasjet në informata të klasifikuara apo sensitive, në mënyrë që të përmbushën nevojat për qasje në material që vjen nga shtete apo organizata tjera. Aso lloj kontrollimesh mund të përmbajnë këto gjëra;

- Kontrollim të kredisë kreditore dhe rishikim të gjëndjes financiare;
- Nje apo më shumë intervista me Ekipin për Verifikim i NATO-s.
- Intervistë me një apo me shumë referenca të përzhgjedhura të cilët nuk janë të rrethit familjar.

Mungesa për të treguar informatë relevante mund të konsiderohet si shenjë e të pavërtetës dhe do të merret parasysh gjatë vlerësimit të statusit verifikues. Pra, është në interesin tuaj që të jeni të sigurtë dhe transparent në përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të shkruara në Aplikacion.

UDHËZIM DHE DREJTIM

Udhëzimet për plotësimin e formularit të aplikacionit për FSK janë dhënë në këtë fletushkë. Përcillni këto udhëzime dhe dorëzoni aplikimin tuaj të plotësuar dhe dokumentet e kërkuara në njërin nga Zyrat Rajonale të Rekrutimit ose tek ndonjë Ekip Mobil i Rekrutimit. Lokacionet e zyrave Rajonale të Rekrutimit, Ekipeve Mobile të Rekrutimit, informatat kontaktuese dhe orari i punës janë të dhëna në Shtojcën A. Kur ta dorëzoni aplikacionin, ju do të merrni një numër si dëshmi se e keni dorëzuar një aplikacion për anëtarësim në FSK. Këshilltarët për Rekrutim janë të vendosur në zyrat Rajonale të Rekrutimit dhe në Ekipe Mobile të Rekrutimit. Ata janë në dispozicion për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave tuaja lidhur me shërbimin në FSK ose plotësimin e këtij formulari të aplikimit.

INFORMATË RRETH VERIFIKIMIT

Nese je i zgjedhur per Sherbim ne Forcen e Sigurise se Kosoves, ju do te jeni per tu verifikuar. Disa prej pyetjeve ne kete aplikacion jane pjese e atij procesi dhe do te perdoren vetem NESE je parazgjedhur. Informata do te trajtohet ne menyren me konfidenciale. Behu transparent dhe i/e sinqerte.

Polica e NATO's rreth Verifikimit shpjegohet ne detaje ne Seksionin 2.

UDHËZIMET

Shënimi 1. Shërbimi në FSK (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #1).

Ju mund të aplikoni në pozitat për oficer apo nënoficer në FSK. Për t'u pranuar si oficer, preferohet diploma universitare. Për gradat e nënoficerëve kërkohet shkolla e mesme e kryer.

Shënimi 2. Profesioni i detyres (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #2).

Nëse keni profesion i cili kërkohet nga FSK-ja, ju lutem shkruani kodin e profesionit. Profesionet dhe kodet e tyre mund të gjinden në Aneksin A, në fund të kësaj fletushke.

Shënimi 3. Detajet personale (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #3).

Ju lutemi shënoni mbiemrin tuaj ashtu siç figuron në dokumentin tuaj valid të identifikimit. Nëse ndodh ndonjë ndryshim në detajet tuaja gjatë procesit të aplikimit, informoni këshilltarët për rekrutim sa më shpejt që të mundeni. Aplikuesve për FSK u kërkohet që të dorëzojnë nga një kopje të çertifikatës së lindjes ose ndonjë dokument të shtetësisë që e vërteton moshën e tyre. Dorëzoni një kopje të çertifikatës suaj të lindjes apo një dokument të shtetësisë që e vërteton moshën tuaj.

Shënimi 4. Rrethanat personale (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #4).

FSK-ja mund të kërkojë nga ju që të shërbeni larg nga vendi ku jetoni për periudha të zgjatura kohore. Për këtë arsye, rrethanat tuaja personale nuk duhet t'ju pengojnë në kryerjen e detyrave në mbështetje të misionëve FSK-së.

Shënimi 5. Shtetësia (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #5).

Anëtarët e FSK-së duhet të jenë shtetas të Kosovës dhe gjithashtu mund të jenë edhe shtetas të një ose më shumë shteteve tjera. Aplikantët duhet të dorëzojnë një kopje të dokumentit që dëshmon shtetësinë e Kosovës. Ju lutem ta dini se letërnjoftimi duhet te jete i paskaduar kur te aplikoni ne FSK.

- a. Letërnjoftimi apo Pasaporta e Kosovës – Procedurat për marrjen e këtyre dokumenteve janë të dhëna në linkun <http://www.mpb-ks.org/?page=2,1>
- b. Letërnjoftimi i UNMIK-ut (ose numri personal) ose dokumenti i udhëtimit i UNMIK-ut – Këto dokumente nuk lëshohen më, por mund të përdoren si dëshmi e shtetësisë sipas Ligjit mbi Shtetësinë (neni 28). Ky ligj përcakton se çdo person i cili është i regjistruar si banor i Kosovës, sipas rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 në Regjistrin

Qendror Civil duhet të konsiderohet si qytetar i Kosovës dhe do të regjistrohet si i tillë në regjistrin e shtetasve.

Shënimi 6. Përkatësia etnike (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #6).

Shënimi i përkatësisë suaj etnike është vullnetar. Kjo informatë do të trajtohet me besim të plotë të plotë dhe do të përdoret për të monitoruar në mënyrë adekuate përbërjen etnike të FSK-së.

Shënimi 7. Identifikimi kombëtar (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #7).

Shënoni informatat e kërkuara.

Shënimi 8. Patent shoferi (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #8).

Shënoni informatat e kërkuara.

Shënimi 9. Përkatësia politike (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #9).

Ligji mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës përcakton se anëtarët e FSK-së nuk mund të jenë anëtarë të partive politike dhe nuk mund të paraqesin shenja të dukshme të përkrahjes së ndonjë partie politike.

Shënimi 10. Shkollimi dhe kualifikimet (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #10).

Kualifikimet minimale shkollore për hyrje në FSK janë si vijon:

- (1) Për nënoficer – kërkohet shkolla e mesme e kryer.
- (2) Për oficer – preferohet diploma valide universitare.

Aplikacionet e FSK-së duhet të ofrojnë dëshmi për kualifikimet shkollore. Ju mund të dorëzoni një kopje të diplomës suaj dhe/ose certifikatat e kryerjes së kureve për t'i dëshmuar kualifikimet tuaja shkollore.

Shënimi 11. Gjendja mjekësore (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #11).

Historia juaj mjekësore është e besueshme dhe nuk do t'i paraqitet askujt përpos atyre që janë të autorizuar për t'i pasur këto informata. Duhet të jeni të vetëdijshëm se gjatë këtij kontrolli mjekësor do të bëhet edhe një test për substanca narkotike. Shënoni nëse keni ndonjë paaftësi ose nëse vuani/keni

vuajtur nga ndonjë sëmundje që mund t'ju pengojë në kryerjen korrekte të punës për të cilën po aplikoni. Shënoni gjatësinë dhe peshën tuaj.

Kushtet në vijim rezultojnë në vonesë të përkohshme në procesin e përzgjedhjes. Aplikuesit do të konsiderohen për hyrje në FSK pas dorëzimit të një certificate nga një profesionist mjekësor që dëshmon se jeni shëruar plotësisht dhe se jeni të aftë për t'iu nënshtruar trajnimeve të vështira:

- (1) Shtatëzania deri në 6 muaj pas përfundimit të shtatëzanisë.
- (2) Pritja për ndonjë operacion ose mjekim.
- (3) Sëmundje apo lëndim i rëndë i përkohshëm.

Shënimi 12. Fitnesi fizik (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #12).

Anëtarët e rinj të FSK-së do t'iu nënshtrohen trajnimeve intenzive që kërkojnë shumë fizikisht dhe janë të lodhshme mentalisht. Për t'iu kualifikuar për anëtarësim, aplikantët duhet të jenë në gjendje të mirë fizike e mendore dhe jo në gjendje të dobët.

Shënimi 13A. Të dhënat e punësimit (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #13).

Jepni të dhënat e punësimit për dy vendpunimet e fundit duke filluar nga ai i fundit.

Note 13B: Interesa ne Biznes

Me rendesi: Anëtarët e FSK-se nuk kanë te drejte te perfitojne (perveq rroges se FSK-se) ndoj rroge tjeter perveq asaj ne FSK. Anëtarët e FSK-se nuk kanë te drejte te inkuadrohen ne punesim te dyte, perfshire ketu edhe biznese private, pa aprovimin e Oficerit Komandues dhe vetem ne perpuethshmeri me Rregulloren perkatese.

Shënimi 14. Shërbimi ushtarak (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #14).

Jepni informata mbi shërbimin ushtarak. Nëse nuk keni shërbyer, tregoni duke shenjuar katrorin "Jo". Nëse keni përvojë në më shumë se një shërbim, radhitni shërbimet shtesë në pikën # 17 të aplikacionit.

Shënimi 15. Dosja penale (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #15).

Sipas Kodit Penal, nuk jeni të obliguar që t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje. Megjithatë, nëse zbulohet se keni dhënë informata të rrejshme, ju do të shkarkoheni.

Jepni informata për çdo shkelje penale që ka rezultuar me burgim e që nuk është hequr nga dosja e juaj penale dhe që konfirmon se nuk i nënshtroheni hetimeve penale ose ndonjë hetimi kriminal apo persekutimi në vijim. Çdo aplikant që është gjykuar për ndonjë shkelje penale që ka rezultuar me burgim nuk do të pranohet në FSK.

Shënimi 16. Referencat për karakterin (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #16).

Të gjithë aplikantët duhet t'i emërojnë dy referenca për karakterin. Këto referenca mund të jenë nga ndonjë punëdhënës i mëparshëm, anëtar i stafit të ndonjë shkolle, kolegji apo nga komuniteti.

Eshte me rendesi se referenca eshte e pamvaruar dhe JO i rrethit familjar.

Shënimi 17. Informatat shtesë (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #17).

Kjo pjesë është dhënë për ndonjë informatë shtesë të cilën mund t'ju nevojitet që ta përfshini në aplikacionin tuaj. Kjo informate do te trajtohet ne konfidence.

Shënimi 18. Deklaratë (Shih Formularin e Aplikimit, Pika #21).

Me nenshkrimin e ketij aplikimi, ju konfirmoni se informacioni i dhene eshte i vertete dhe i sakte. Dhenja e informates jo te vertete apo mungesa per te nenshkruar dhe per te ven daten ne Aplikacion do te rezultoj ne perjashtimin e aplikimit ose perjashtimit nga FSK-ja.

ANNEX A

PËRSHKRIMI I DETYRAVE TË PUNËS NË FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

Administratë

Si administrator, ju do të jeni përgjegjës për mbështetjen administrative të zyrës dhe njësisë ku punoni. Rutina ditore e punës do të përfshijë përgatitjen e korrespondencës ditore, menaxhimin e databazës duke filluar nga personeli, databazave të dokumenteve dhe materialeve, koordinimin dhe menaxhimin e orarit të aktiviteteve, regjistrin telefonik dhe regjistrin të pushimeve. Ju do t'i siguronit dhe menaxhoni materialet për zyrë dhe sipas dëshirës edhe pajisjet e Sistemit Informativ të Komunikimit. Ju gjithashtu mund të jeni përgjegjës edhe për sistemin e arkivimit të njësisë, buxhetit të përcaktuar ose të kryeni detyrën e vozitësit, nëse kërkohet.

Komunikim

Mund të jeni të interesuar të aplikoni në njërin nga dy fushat kryesore të komunikimit. Fusha e parë përfshin teknologjinë informative (TI) ku do të veproni si menaxher apo administrator i Sistemit të Informimit dhe Komunikimit (SIK) duke mbështetur oficerët e shtabit në të gjitha çështjet e SIK-ut duke përfshirë riparimin e defekteve dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të SIK-ut. Fusha e dytë përfshin Pajisjet Statike të Telekomunikimit e cila ofron kushtet e punës për fushën e TI, si p.sh. lidhjen kabllorike, si dhe përfshin mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemit të komunikimit në të gjithë Kosovën.

Mbrojtje civile

Në kuadër të mbrojtjes civile, ju mund të punësoheni në njësitë e Shkatërrimit të Mjeteve Shpërthyes, Materieve të Rrezikshme, Kërkim-Shpëtimit ose Zjarrfikjes. E ardhmja e përbashkët e njësisë është aftësia për reagim të shpejtë në raste të incidenteve, komandimin dhe kontrollin e tyre. Nëse punësoheni në njësinë e Shkatërrimit të Mjeteve Shpërthyes ju do të bëni kërkimin, do të identifikoni kërcënimet, dhe do t'i pastroni zonat nga mjetet shpërthyes si p.sh nga minat, municioni i pashpërthyer artilerik dhe mjetet tjera shpërthyes. Në njësinë e Materieve të Rrezikshme do të detektoni, shënoni dhe kimikisht t'i dekontaminoni materiet e rrezikshme. Në njësinë e Kërkim-Shpëtimit do të veproni si oficer shpëtimi për zonat urbane, ujore, malore dhe në aksidente trafiku, si dhe do të keni mundësi specializimi si teknik medicinal, ushtrues i qenve ose zhytës. Si Zjarrfikës ju do të reagoni në incidentet që mund të ndodhin në kazernat e FSK-së, si dhe t'i ndihmoni shërbimet e emergjencave civile në të gjithë Kosovën.

Inxhinieri

Në inxhinieri, ju mund të operoni me makineri inxhinierike si p.sh buldozer, eskavator, makina speciale transportuse ose pajisje për ngarkim. Ju po ashtu mund të punoni si mekanik dhe të bëni mirëmbajtjen e pajisjeve inxhinierike. Përveç kësaj, ju mund të punoni si specialist i urave, dhe të jeni përgjegjës për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre në të gjithë Kosovën. Ju gjithashtu mund të jeni mirëmbajtës i kazermave të FSK-së si instalues uji, murator, elektrikist, zdrukhtar ose specialist për instalimin e gazit.

Forcë Policore

Si anëtar i forces policore, ju do t'i kryeni detyrat e sigurisë fizike për mekanizma, objekte dhe pajisje. Ju mund të ushtroni zbatimin e ligjit, operacione të forcës policore, kontrole trafiku, patrullime dhe kontrole të sigurisë. Ju do të kryeni hetime, inspektime, intervista me personel, do të përpiloni raporte dhe të jepni rekomandime mbi ato çështje që ndodhin në raport me ligjin dhe sigurinë.

Instruktur

Si instruktor, ju do ta bëni trajnimin themelor të rekrutëve të FSK-së apo trajnimin e specializuar për specialistët e FSK-së. Si instruktor i trajnimit të specialistëve, ju do të specializoni në mbrojtje civile, inxhinieri, logjistikë, vozitje, komunikim apo trajnim fizik. Ju gjithashtu mund të bëni trajnime kolektive apo simulative si Instruktur i Udhëheqjes dhe Zhvillimit Personal apo të ofroni trajnime në gjuhët e huaja.

Siguri/Inteligjencë

Në siguri dhe inteligjencë, ju do të identifikoni kapacitetin dhe qëllimet e rreziqeve dhe do të zhvilloni plane të reagimit duke mbledhur, rishikuar, analizuar dhe ndërlidhur të dhënat e inteligjencës. Ju do të përgatitni informata, siç janë raportet, vlerësimet, udhëzimet dhe rezultatet tjera të nevojshme të inteligjencës. Në inteligjencë ju gjithashtu mund të shërbeni si përkthyes, duke përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze apo serbe dhe anasjelltas.

Logjistikë

Në logjistikë, ju mund të punësoheni në degën e transportit, mirëmbajtjes, furnizimit apo shërbimit të ushqimit. Në transport, ju mund të ushtroni detyrën e shoferit të kamionit apo të shoferit të personave me rëndësi të veçantë. Në mirëmbajtje, ju do të bëni mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike, armëve, municionit dhe automjeteve të FSK-së (mekanik, elektrikist i automjeteve, ngjyrosës i automjeteve dhe saldues). Në furnizim, ju do të menaxhoni me të gjitha pajisjet dhe mallrat e konsumit. Në shërbimin e ushqimit, ju do të punoni si kuzhinier apo specialist i shërbimit të ushqimit.

Mjekësi

Në profesionin mjekësor, ju mund të punësoheni si teknik medicinal që ndihmon në të gjitha detyrat e reagimit të parë dhe/ose në përcjelljen dhe trajtimin e pacientëve gjatë evakuimeve mjekësore. Njohuria si teknik mjekësor gjithashtu kërkohet për disa detyra të mbrojtjes civile, si p.sh. për disa zjarrfikës dhe oficerë të shpëtimit.

Detyra të përgjithshme

Detyrat e përgjithshme janë detyra ku nuk është kërkesë primare specializimi në ndonjë profesion të caktuar. Shumica e detyrave lidhen me detyrat e planifikimit, operacioneve, trajnimit dhe bashkëpunimit civil-ushtarak.